

NË EMËR TË POPOULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit A.S. nga fsh. ..., kom. ..., të cilin e mbron av. B.I. nga ..., për shkak të veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379.paragr.1 KPRK dhe veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.666/18 të dt. 15.05.2018, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Shefik Memeti, pas mbajtjes së seancës fillestare orale e publike lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të lidhur në prokurori më dt. 15.05.2018, më dt. 16.05.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.S. nga babai B. dhe nëna Z. – R., i lindur më dt. data e lindjes... në ..., jeton në fsh. ..., kom. e ..., me punë dhe vendbanim të përkohshëm në ..., i pamartuar, i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si instruktor në Auto-Shkollë në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I

Sepse më dt. ... rreth orës 00:30 minuta në rrugën “ ... ” përballë Qendrës Tregtare “ ... ” në ... i pandehuri A.S. ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që në kundërshtim me nenin 227 pika 5 të Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit në Rrugor i Republikës së Kosovës, në gjendje të dehur ka drejtuar automjetin e markës “ ... ” me targa të regjistrimit ... dhe gjatë drejtimit të automjetit i njëjti ka manovruar me automjet në mënyrë jo të rregullt dhe në momentin kur është ndalur nga policia për kontroll, i njëjti kundërmonte nga era e alkoolit, ka kundërshtuar të prezantoj dokumentet e identifikimit dhe patentë shoferin, me ç'rast i njëjti është arrestuar dhe shoqëruar për në stacionin policor në Gjilan, pastaj, i pandehuri në mënyrë kategorike ka refuzuar t'i nënshtrohet alko-testit për të verifikuar promilët në gjak, në këtë mënyrë i pandehuri duke ngarë automjetin e tij në gjendje të paaftë apo të dehur, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre.

me çka ka kryer veprën penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379.paragr.1 KPRK

II

Sepse dhe vendin e përshkruar në dispozitiv të kësaj aktakuze i pandehuri A.S. në zyrat i Intervistimit të Stacionit Policor në Gjilan, e sulmon personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, policin, tani të dëmtuarin R.H., në atë mënyrë që

përderisa polici R.H. ia kishte ofruar aparatën e alko-testit për të verifikuar përqindjen e alkoolit në gjak, i pandehuri fillimisht e refuzon, e pastaj nga revolta e sulmon duke e shtyrë të dëmtuarin R.H. me duar dhe duke e goditur me shqelma në këmbë dhe pjesë të ndryshme të trupit, ndërsa në këtë situatë të krijuar intervenojnë policët që ishin prezent, të njëjtin e vejnë nën kontroll dhe e prangosin, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta, duke përdorë forcë ka sulmuar personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

- me çka ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.paragr.1 KPRK

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,46,47,49,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 361i 365 KPPK të pandehurit i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) € i cili do të paguhet menjëherë, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të revokohet dhe i njëjti do t'i zëvendësohet me dënimin me burg në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 20 € për një ditë burgu.

*II. Të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues **NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT** në Republikën e Kosovës në afat prej 1(një) viti, duke filluar nga dita kur i pandehuri të bëj pagesën e dënimit me gjobë apo nga dita kur i njëjti të vuaj dënimin me burg, në rast se nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë tjetër vepër penale të kësaj natyre, në të kundërtën vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues do të revokohet.*

Për veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.paragr.1 KPRK, shqiptohet dënimi si vijon:

III. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh kështu që i njëjti dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

IV. Në dënimi e shqiptuar me burg të pandehurit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 07.05.2018 deri në ditën kur të ndërpritet paraburgimi nga ana e gjykatës, pra më dt. 16.05.2018.

V. Me pëlqimin e të pandehurit të njëjtit i mundësohet që dënimi i shqiptuar me burg, i cili është zëvendësuar me dënimin me gjobë dhe atë në shumë prej 1800.00(njëmijëetëqind) €, me ç'rast i pandehuri dënimin e zëvendësuar me gjobë është i obliguar ta paguaj menjëherë pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, në të kundërtën vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burg në dënimin me gjobë do të revokohet dhe i pandehuri do ta vuaj dënimin me burg si në dispozitivin III të kësaj marrëveshje.

VI. Në bazë të nenit 80.paragr.,1 lidhur me paragr.2 nënparagr.2.2 KPRK për të dy verpat penale të përshkruara në dispozitivin I dhe IV të kësaj marrëveshje, të pandehurit do t'i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 2.400 (dymijëekatërqind) €.

VII. I dëmtuari R.H. – polic në stacionin policor në ..., për realizimin e kërkesës pronëso-ro-juridike, udhëzohet në kontestin civil.

VIII. Në pajtim me nenin 39 paragr.3 nënparagr.3.1 Ligji mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit, i pandehuri obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj taksën në shumën prej 30 €.

IX. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzën PP.nr.666/2018 të dt.15.05.2018, kundër të pandehurit A.S. nga fsh. ..., kom. ..., për shkak të veprave penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379.paragr.1 KPRK dhe sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.paragr.1 KPRK, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Shefik Memeti, në seancën e caktuar lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më dt. 15.05.2018, mbeti pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë të lidhur konform ligjit dhe dispozitave të nenit 233 KPPRK, me ç'rast i pandehuri është njoftuar për pasojat dhe natyrën e nënshkrimit të pranimit të fajësisë dhe mbetet pranë qëndrimit se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata në tërësi të aprovoj marrëveshjen e përmendur.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S., av. B.I., në tërësi është pajtuar me propozimin e prokurorit së shtetit që propozimi të aprovohet, se me rastin e arritjes së marrëveshjes i akuzuari është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë, është pajtuar me këtë dhe garanton se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin sepse sinqerisht e ka pranuar fajësinë. I pandehuri pendohet për veprën e kryer, deri sot nuk ka qenë i gjykuar, andaj, lutë gjykatën që të ketë parasysh këtë fakt, sepse edhe me këtë dënim ka për tu arritur qëllimi i ndëshkimit.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë i përmban të gjitha faktet, propozimin për arritje të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, njoftimin e të akuzuarit me të drejtat e tij dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhënia e deklaratës me shkrim, se i njëjti ka pranuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se të gjitha këto i ka pranuar me vullnetin e tij të lirë.

Gjykata gjen se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal konform nenit 233 KPPRK dhesë e njëjta marrëveshje është në harmoni me kushtet e parapara me nenin pikën 12 të këtij neni.

Gjykata vërtetoi se i akuzuari i ka kryer veprat penale dhe konstatoi se nuk ekziston asnjë rrethanë për përjashtim e paraparë me nenin 248 KPPRK.

Gjykata aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të PTH-Departamentit të Përgjithshëm nga njëra anë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nga ana tjetër për kryerjen e veprave penale të cekura në aktakuzën PP.nr. 666/2018 të dt.15.05.2018, pasi që për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore

Gjykatësja e vetme gjykuese vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, e pas konsultimit me mbrojtësin e tij, se i pandehuri në asnjë mënyrë nuk ka qenë i detyruar të pranoj fajësinë. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e cekura në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253.paragr.1 KPPRK.

Gjykata është e bindur se shqiptimi i dënimit me gjobë është në harmoni me peshën e kryerjes së veprës penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41. KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 KPPRK ndërsa vendimi mi kërkesën pronësoro juridike është marr në bazë të nenit 463 KPPRK.

Në bazë të cekurave të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.428/2018 më dt. 16.05.2018**

*Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević*

*Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq*

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –
Naile Keçmezi**

